



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 17 tetor 2014, në mbledhjen e X-të (dhjetë) të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm, z. Agim Kikaj, Nënkryetarë i Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, z. Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit dhe një numër i qytetarëve.

➤ **Propozimi i vendimit për ri-alokim dhe tranfer të projekteve për vitin 2014**

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, në fjalën hyrëse i njoftoj këshilltarët e Kuvendit të Komunës për arsyen e thirrjes së kësaj mbledhje të jashtëzakonshme, dhe rekomandimet e dala nga Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe shtoi, jeni në dijeni se ky Kuvend më 17 korrik 2014 ka marr Vendim për rishikimin e buxhetit për vitin 2014, mirëpo shkak i mos konstituimit të Kuvendit të Kosovës ai vendim dhe ato mjete dhe projekte qe tre muaj nuk kanë mundur të zbatohet dhe kanë qenë të bllokuara. Gjithashtu i është bërë kërkesë edhe Ministrisë së Financave, për rregullimin e buxhetit mirëpo meqë vetëm Kuvendi i Kosovës është organi legjitim i cili miraton rishikimin e buxhetit të Komunave, Ministria ka rekomanduar se vetëm Kuvendi i Kosovës mund të miratoj vendim për rishikim të buxhetit të Komunave, mirëpo Kuvendet e Komunave mund të miratojnë vendim për ri-alokim dhe transfero të projekteve, andaj Ekzekutivi i Komunës menjëherë ka përgatit këtë propozim vendim.

Me ri-alokim nënkuptohet rregullimi i buxhetit për projektet kapitale apo bartja e mjeteve buxhetore dhe transferi i projekteve brenda një viti fiskal që do të thotë se në ato kategori në të cilat ka tepriçë të mjeteve ato barten në projekte të cilat kanë mungesë të mjeteve. Jeni në dijeni se kanë mbetur edhe dy muaj për pagesa për investime kapitale, andaj me miratimin e këtij propozim vendimi do të shmangim suficitin apo deficitin e buxhetit të Komunës së Podujevës.

Pra materialin e keni marrë, drejtorët e Drejtorive të Komunës i kemi prezent për çfarëdo sqarimi apo përgjigjeje, por meqë ky propozim dallon shumë pak nga ai i rishikimit të buxhetit konsideroj se të gjitha i kemi debatuar në atë mbledhje dhe nuk ka shumë për tu

thënë në këtë mbledhje, mirëpo kjo nuk do të thotë se këshilltarët e Kuvendit nuk kanë të drejtë për të debatuar për të dhënë propozime, vërejtje nëse ka dhe sugjerime.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, në Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e kemi shqyrtuar dhe analizuar këtë propozim vendim për ri-alokim dhe transfer të projekteve për vitin 2014, propozim për të cilin konsiderojmë se është në përputhje të plotë me ligjin përkatës, andaj për këto dhe shumë arsye tjera e përkrahim këtë propozim vendim.

z. Kadri Avdiu, theksoi, edhe një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi diskutuar këtë propozim vendim dhe nga subjekti të cilin e përfaqësoi unë është vërejtja se Ekzekutivi i Komunës nuk e respekton Kuvendin e Komunës, e them këtë ngase shpesh herë në këtë Kuvend me shumicë votash janë miratuar projektbuxhete mirëpo gjithherë ato brenda një kohe të shkurt kanë rënë në kundërshtim ngase janë bërë ndryshime të projekteve pa pëlqim të Kuvendit si dhe shpeshherë ka pasur intervenime nga ana e Ekzekutivit të Komunës pa qenë të parapara në projektbuxhet ku është investuar në disa pjesë dhe në disa projekte pa pasur mjete buxhetore të zotuarra pastaj në vitet pasuese janë bërë pagesat për ato intervenime të viteve paraprake, gjëra që kanë ndodhur kryesisht në kohë të fushatave zgjedhore. Ne para tre muajve në këtë Kuvend kemi miratuar një vendim me të cilin kemi ridestinuuar mjete buxhetore dhe projekte të ndryshme ndërsa tani vetëm ndërrohet emërtimi dhe bëhet ri-alokim, e që nga investimet e parapara për Lagjen e Dëshmorëve hiqen 60,000.00 €, pastaj nga projekti për asfaltimin e rrugëve në fshatin Kërpimëh hiqen 50,000.00 € dhe barten në projektin për asfaltimin e rrugës në fshatin Balloc në shumë 203,203.00 €, pra nuk do të thotë se ato mjete kanë tepruar nga Lagja e Dëshmorëve dhe nga projekti i fshatit Kërpimëh ose dy - tri projekte tjera dhe janë bartur në fshatin Balloc, këtë nuk e kuptoj dhe kërkoj sqarim, ngase janë marrë mjete buxhetore nga katër projekte dhe ja bartur në asfaltimin e rrugës në fshatin Balloc. Pastaj kemi bartje të mjeteve në pjesë tjera ku nga fshati Pakashticë e Epërme dhe ajo e Ulët hiqen mjete në shumë 40,000.00 € dhe barten në tri segmente në fshatrat Katunishtë dhe Obranqë. Pra mora vetëm disa shembuj ngase edhe për të gjitha bartjet nga një kod buxhetor në tjetrin për ne është e papranueshme ngase ne mendojmë se këto ndryshime janë si pasojë e mungesës së planifikimit e që ne shpeshherë e kemi thënë se në çdo fillim vit duhet të bëhet planifikimi se ku do të investohet dhe kemi bërë vërejtje në këtë mënyrë ku bëhen përshkrime vetëm sa për tu arsyetuar mjetet buxhetore e pastaj ndryshohen ku dhe si të dëshirojnë duke u bazuar në logjikën e shumicës në Kuvend.

As ne si opozitë nuk jemi për të humbur mjetet buxhetore por mendojmë se për të mos ardhur deri te një situatë e tillë është dashur të bëhen planifikimet me kohë dhe të miratohen në Kuvend ndërsa në këta muajt e fundit mund të ndodhë që të bëhet rishikimi i buxhetit dhe të barten mjetet nga ndonjë projekt ku ka tepriçë të mjeteve në projekte të cilat kanë mungesë të mjeteve, por jo të bëhet ri-alokim i mjeteve në shumë kaq të madhe 773,866.00 €. Gjithashtu 3-4 vite me radhë kemi mjete të parapara për zgjerimin e lumit nga diga e liqenit të Batllavës dhe për çdo vit hiqen me rishikim sikurse këtë vit që hiqen nga tri kode në shumë të përgjithshme prej 65,000.00 € të cilat barten për projekte për kanalizime, gjë e cila është absurde që barten mjete të cilat janë të parapara për zgjerimin e lumenjve, kur dihen dëmet që janë bërë nga vërshimet, ndërsa barten në ndërtim të kanalizimeve dhe bëhen gypa tjerë të cilët derdhen në po ato lumenj.

Prandaj konsiderojmë se kjo politikë është politikë jo e mençur dhe jo e mirë sepse me mos punë të mirë po i'u shkaktojmë dëme qytetarëve tanë, dhe familjeve tona, ngase jemi në dijeni se kemi pasur një rast në fshatin Tërnavë ku familja ka qëndruar në një objekt të pabanueshëm shkaku i vërshimeve dhe ngushtimit të lumenjve, ku edhe komisioni përkatës e ka konstatuar atë gjendje, pastaj ka shkuar një komision shtesë dhe e ka verifikuar gjendjen dhe ka konstatuar se nuk ka nevojë të intervenohet, jam në dijeni se Ekzekutivi i Komunës nuk i ka ngushtuar lumenjtë mirëpo Ekzekutivi dhe komplet qeverisja komunale është përgjegjëse për intervenime aty ku paraqitet nevoja. Kamë parë në fshatin Bellopojë ku në një pjesë është bërë zgjerimi i lumit dhe sinqerisht është kënaqësi të shohësh atë pjesë mirëpo është dëm i madh që ka qenë e paraparë të zgjerohet edhe në fshatin Tërnavë një pjesë prej 750 metrash gjë e cila ende nuk është bërë, kurse unë dëgjova që janë paraqit disa pengesa, andaj e them se mu atëherë kur paraqiten pengesa, Ekzekutivi i Komunës duhet të intervenoi dhe të bëjë alokimin e atyre mjeteve për ti shpenzuar ndokund tjetër. Konsideroj se është për keqardhje që me këtë ri-alokim largohen nga investimet dhe iu hiqen mjetet buxhetore të parapara për investime pjesës dërrmuese të fshatrave dhe që ato mjete dhe ato investime barten vetëm në tri apo katër fshatra, është e papranueshme për ne, jo vetëm se jemi opozitë, por vërtetë janë vërejtje me të cilat kërkojmë të përmirësohet njëherë e përgjithmonë kjo qeverisje ngase buxheti nuk është as i Qeverisë së Kosovës as i Ekzekutivit të Komunës por është i qytetarëve dhe në interes të qytetarë duhet të shpenzohet dhe të investohet, kurse obligim i qeverisjes është menaxhimi i mirë tyre.

z. Haki Rudari, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje e kemi analizuar këtë propozim vendim dhe kemi ardhur në përfundim se ky ri-alokim dhe transfer i mjeteve për vitin 2014 është pasojë e menaxhimit të dobët, pasojë e mungesës së një plan programi dhe si pasojë e projekteve të pambuluara, gjëra të cilat i shtroj edhe si pyetje dhe kërkoj përgjigje. Në vazhdim do t'i paraqes disa ri-alokime dhe transfere për të cilat ne mendojmë se janë plotësisht të paarsyeshme dhe që konsiderojmë se janë në kundërshtim me interesin e qytetarëve.

1-konsiderojmë se është e papranueshme dhe e paarsyeshme që nga Lagja e Dëshmorëve ri-alokohen mjete buxhetore dhe barten në një projekt tjetër, ngase jemi në dijeni për gjendjen shumë të rëndë e cila mbretëron në atë Lagje, këtë e them edhe nga pozita e anëtarit të komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, dhe konsideroj se në atë Lagje është dashur të ketë projekte dhe investime tjera me mjete tjera dhe jo të merren edhe ato mjete të parapara.

2-mendojmë se është gabim dhe e dëmshme që të merren mjete dhe të barten nga fshati Surdull kur kemi parasysh se është një fshatë malor dhe përgjatë brezit kufitar, dhe konsideroj se në atë fshat është dashur të investohet dhe të ketë projekte më shumë për arsye se vetëm me investime mund të shmangim shpërnguljen e atyre qytetarëve që jetojnë në atë fshat.

3-gjithashtu është plotësisht e paarsyeshme ku projektet e papërfunduara, siç ishte projekti paraprak në shumë 71,289.00 €, barten dhe nuk specifikohen por vetëm përcillet me emërtimin, projekte, disa herë.

4-pastaj të merren mjete nga projekti për kolektorin e ujërave të zeza i paraparë në fshatin Gllamnik, dhe të barten në një vend tjetër, me të vërtetë është e paarsyeshme, unë personalisht e njoh shumë mirë atë vend dhe mendoj se është dashur të ketë më shumë projekte sikurse që është dashur të investohet më shumë në fshatin Siboc.

5-po ashtu shuma 48,600.00 € e paraparë për zgjerimin e lumit nga diga e Liqenit të Batllavës e që me këtë ri-alokim hiqen dhe barten në një projekt tjetër në një vend tjetër mendojmë se nuk është në dobi të qytetarëve, e them këtë ngase në kohën e pranverës zakonisht kur kemi vërshime dhe shkrije të borës nga ai lokalitet kemi shumë ankesa nga qytetarët për dëmtime të natyrave të ndryshme.

6-ajo që ne mendojmë se është shumë e paarsyeshme dhe e papranueshme është zgjerimi i shtratit të lumit Llap në fshatin Lupç, shuma 20,000.00 €, kur kemi parasysh se gjatë kohës së vërshimeve ka pasur premtime të mëdha nga ana e drejtorëve të Drejtorive përkatëse, se ajo pjesë do të jetë në prioritet dhe se në atë pjesë do të ketë investime, tani na del e kundërta dhe në atë pjesë merren mjete buxhetore, dhe çka do t'i u themi qytetarëve nëse në të ardhmen ndodhin vërshime, është procesverbali kur ne si Grup nga LVV-ja dhe kolegë tjerë nga subjektet tjera kemi thënë se në atë pjesë duhet të investohet në mënyrë emergjente, ndërsa tani merren edhe ato mjete të parapara.

7-pastaj për ne është e papranueshme që të merren dhe të harxhohen 30,000.00 € për blerjen e automjeteve zyrtare, sepse mendojmë se Komuna ka automjete të mjaftueshme, kurse nuk vërehet asnjë shumë buxhetore ri-alokuar në Drejtorinë e Arsimit kur kemi parasysh se nevoja për investime në Arsim është e madhe, por edhe rasti i fundit që kemi ndërprerje të transportit të nxënësve pikërisht për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore.

Çështje tjetër që vlen të ceket ka të bëjë me kanalizimin dhe rrugët e qytetit, një ditë më parë rruga nga Hotel Besiana deri afër Komunës ka qenë e mbuluar me ujë nga reshjet e shiut, dhe shtrohet pyetja pse ndodh kjo, kurse në bazë të informatave që kemi ne si Grup i këshilltarëve, gypat e kanalizimit në qytet janë Ø-200, kështu që është dashur në mënyrë emergjente të intervenohet në qendër të qytetit, dhe çështja tjetër shqetësuese është se ende ka rrugë në qendër të qytetit që nuk janë të asfaltuara, Prandaj në emër të Grupit të LVV-së nga të gjitha këto që i ceka mund të vijmë deri te një përfundim se ky ri-alokim dhe transfer i projekteve nuk është në dobi të qytetarëve dhe na bëjnë që të votojmë kundër këtij propozim vendimi.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, Kryesuesi i Kuvendit nuk ju dha mundësi drejtorëve të Drejtorive të sqarojnë dhe të arsyetojnë këtë ri-alokim apo të shprehin mendimin e tyre se si e kanë menduar këtë ri-alokim prej afro 1 milion euro, kurse shpesh herë e kemi thënë se kjo qeverisje nuk mund të del nga rrethi i vet vicioz ku bënë ri-alokim mbi 1 milion euro në tri fshatra në një periudhë ku kanë mbetur më pak se dy muaj pa përfunduar punimet apo për tu mbyllur viti fiskal. z. Fidan Rekaliu e tha se është ri-alokim ligjor, ndërsa unë i'a rikujtoj atij se ky ri-alokim bëhet ligjor vetëm atëherë kur të miratohet, dhe në çoftë se do të ishte në përputhje me ligjin dhe në çoftë se do të ishte planifikim i mirë atëherë nuk do të kishte mbledhje të jashtëzakonshme të KPF-së dhe të Kuvendit të cilën jemi duke e mbajtur tani, por do të kishte mbledhje të zakonshme, pra kjo tregon se ka qenë një planifikim jo i mirë ngase nuk kanë mundur 1 milion euro të shpenzohen. Jemi në dijeni se me lidhjen e një kontrate duhet të ketë mjete buxhetore të parapara, kurse për rrugën e fshatit Balloc në shumë rreth 200,000.00 € nuk ka pasur mjete të parapara kurse tani barten të gjitha ato mjete në atë projekt, projekt për të cilin ose ka pasur kontratë të lidhur në mënyrë të jashtë ligjshme pa pasur mjete të parapara ose ajo kontratë duhet të lidhet tani, për këtë do të ishte mirë që drejtori i Drejtorisë përkatëse të na sqaroj ngase kemi 4 km rrugë të asfaltuara në atë fshat gjë për të cilën mendoj se është gjatësi e madhe sepse fshati Balloc është i vogël për nga territori. Çështje tjetër, janë investimet në

kanalizime në fshatrat Dumnicë dhe Llapashticë, unë e kam vizituar fshatin Dumnicë dhe punimet që janë bërë konsideroj se në atë vend është bërë degradim sepse është bërë thellimi i lumit afro 5 m. dhe afër 3 m. është zgjeruar ku janë bashkuar dy kanalizime nën një urë e cila është vetëm 1.80 m. e gjerë, pra kërkoj arsyetime nga drejtori i Drejtorisë përkatëse, pse bëhet ri-alokim i këtyre mjeteve në fshatin Dumnicë dhe ri-alokimi tjetër në fshatin Llapashticë në shumë 59,000.00 €, kur jemi në dijeni se 1 metër kanalizim nuk kushton më shumë se 1000,00 €.

Gjithashtu Kryesuesi i Kuvendit e tha se me këtë ri-alokim duhet të plotësohen mjetet e papaguara, unë mendoj se çdo kontratë ligjore të cilën e lidhë prokurimi dhe pastaj duhet të plotësohet ajo kontratë me një shumë kaq të madhe rreth 200,000.00 €, dhe nëse mundeni ndokush nga të arsyetoni këtë shumë dhe punën që është bërë për t'i ri-alokuar 200,000.00 € atëherë unë do të pajtohesh. Çështje tjetër e cila ka të bëjë me bartjen e mjeteve nga Shëndetësia në projektin për ndërtimin e shtëpive sociale, bartje për të cilën një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Kuvendit e tha se kemi qenë të obliguar të lidhim një kontratë me ndërtuesin e shtëpive sociale për arsye se ka qenë oferta më e lirë, ndërsa Ligji i Prokurimit nuk e thotë ashtu por e thotë se nëse në hapjen e ofertave ka ndonjë ofertë e cila është më e lira por me shumë më të madhe se mjetet e zotuar, ajo ofertë duhet të përsëritet, pra këtu kemi të bëjmë me 100,000.00 € të zotuar për ndërtimin e shtëpive sociale kurse kontrata është lidhur në shumë 110,000.00 € ku 10,000.00 € merren nga Shëndetësia dhe barten në atë projekt, nuk e kontestoj këtë shumë por mendoj se është jo ligjore mënyra e lidhjes së kontratës, sikurse që mendoj se ky ri-alokim është jashtëligjorë dhe Grupi i këshilltarëve nga opozita nuk e voton këtë ngase dikush duhet të jap llogari në të ardhmen. Ne do të angazhohemi dhe do të gjejmë bazë që ky ri-alokim është jashtë ligjor dhe se është vetëm propozim vendim i drejtorëve të Drejtorive për t'i orientuar 1 milion euro në vetëm tri fshatra një muaj pa mbaruar viti fiskal, ne nuk e votojmë këtë ri-alokim për qejf të askujt, e them këtë ngase ende nuk është e mundur për asnjë projekt të dilet nga rrethi vicioz i fshatit Bradash ku edhe në këtë ri-alokim janë bartur 4,000.00 €, ngase nuk ka qëndrim askush nga Ekzekutivi i Komunës të thotë jo për projektet e orientuara në atë fshat. Vlen të ceket se fshatrat që i kanë borxhet më të mëdha Komunës në tatim janë Dumnica, Llapashtica dhe Bradashi, ngase kemi raste ku për rexhistrim të automjeteve që merren vërtetimet e tatimit në pronë pa paguar tatimin në pronë, gjë për të cilën mendoj se dikush duhet të jap llogari. z. Faik Muçiqi, në mbledhjen e kaluar ka thënë se janë kthyer 28,000.00 € për rregullimin e kanalizimit në fshatin Dyz, mirëpo tani unë shoh se prapë ato mjete janë marrë dhe janë bartur për rregullimin e kanalizimit në fshatin Dumnicë ku është bërë puna më e keqe e një kanalizimi që mund të ndodhë ndokund, sikurse që kemi infrastrukturën më të keqe të mundshme në qytet pikërisht në rrugën "Zahir Pajaziti", si dhe gjendja më e keqe që mundet me qenë, është në brezin kufitar ku janë hequr mjetet e parapara për katër vite me radhë për investime në fshatrat Surdull dhe Bërvenik por që asnjëherë nuk është investuar por vetëm janë bartur ato mjete.

z. Kumrie Hoti, theksoi, sa i përket ridestinimit të mjeteve buxhetore nga Shëndetësia në projektin për ndërtimin e shtëpive për raste sociale më duhet të theksoi se shumata e paraparë prej 20,000.00 € as për afërsisht nuk i plotëson mangësitë dhe nevojat që ka Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Podujevë dhe ambulancat në lokalitete të ndryshme të Komunës, pa dashur të bëjë më pak të rëndësishme ndërtimin e shtëpive për raste sociale mendoj se ka shumë burime të tjera prej nga mund të merreshin dhe të

barteshin mjetet për ndërtimin e atyre shtëpive por edhe për sistemin shëndetësorë në Komunën e Podujevës, këtë e them duke u arsyetuar në faktin se nuk është mirë të merren mjete buxhetore nga shëndetësia derisa ka probleme me të cilat dhe ballafaqohen punëtorët e shëndetësisë në jetën e përditshme ku pjesë e atyre punëtorëve jam dhe unë, shembull, në shumë ambulanca nuk ka ujë të pijes gjë e cila është primare për funksionimin e tyre siç e kemi rastin në QMF-në në fshatin Kërpimëh ku që tri vite është hapur objekti i ri mirëpo aparatura dhe pajisjet tjera janë të vjetra dhe jashtë funksionimit madje edhe laboratorin nuk është funksional, kur kemi parasysh rreth 6000 banorë të asaj pjese që për një analizë duhet të vihet në qytetin e Podujevës dhe të pritët me orë të tëra, ndërsa në anët tjetër merren mjete buxhetore nga shëndetësia dhe barten në projekte tjera, çështje për të cilën mendoj se nuk është në rregull sepse si ka mundësi të merren mjete buxhetore nga ky institucion i rëndësishëm kur kemi parasysh se dihen nevojat emergjente për intervenime në vetë atë, shembull, kemi mbi 40 pacientë të cilët transportohen në Prishtinë për hemodializë, pastaj në QKMF – Podujevë kemi vetëm një ultratingull funksional e që pacientëve i'u duhet të presin më shumë se dy javë për këtë shërbim, pra pse ekzistojnë këto probleme kur në shëndetësi ka tepriçë të mjeteve, andaj kërkoj që shëndetësia të plotësohet me mjete buxhetore por jo të merren nga ajo.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, rishikimi buxhetit që është bërë në një mbledhje të kaluar dhe tani kur para vetës kemi ndryshimi i atij vendimi me këtë ri-alokim dhe transfer të projekteve, konsideroj se për këtë Kuvend nuk është diçka e re dhe e papritur ngase në këtë mandat Ekzekutivi i Komunës ka dëshmuar që nuk ka objektiva as për vetë Komunën e as për qytetarët e kësaj Komune, këtë e them duke u nisur nga fakti se asnjëherë Ekzekutivi i Komunës nuk i ka paraqitur këtij Kuvendi një planë të punës qoftë afatshkurtër qoftë afatmesëm, mirëpo kemi qeverisje dhe menaxhim të parasë publike nga çasti në çast apo nga nevoja në nevojë. Ne u kemi tërheqë vërejtjen në mbledhjet e kaluara dhe në mbledhjen kur është votuar projektbuxheti i Komunës, dhe unë personalisht kam shpreh dëshirën që Komuna të mos qeverisë me ato projekte të parapara ngase nuk janë në interes të Komunës, por megjithatë ai projektbuxhet është miratuar, gjithashtu ne u kemi tërheqë vërejtjen se janë duke u grumbulluar investimet dhe projektet në disa lokalitete të caktuara kurse me këtë ri-alokim disa qytetarë të disa lokaliteteve të cilët kanë pritur investime tani ato investime nuk do të bëhen. Pra e gjithë kjo e dëshmon një gjë që për fatin e keq të qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe për fatin e keq të Komunës tonë ky Ekzekutiv në aspektin e profesionalizmit dhe në aspektin e përgjegjësisë nuk është në nivelin e duhur ngase nuk është duke u treguar nikoqir i mirë për përkujdesjen dhe shpenzimin e parasë publike në atë që Komunës së Podujevës i takon dhe që e ka në buxhetin e vetë.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, pavarësisht se të gjitha këto gjëra i kemi diskutuar me rastin e miratimit të vendimit për rishikim të buxhetit, mirëpo për të mos mbetur disa dilema mora fjalën me qëllim që t'i jap disa sqarime. Askush nga këshilltarët e deritanishëm nuk e përmendi se krejt ky ri-alokim bëhet si pasojë e mos rishikimit të buxhetit nga ana e Kuvendit të Kosovës, përndryshe ky debat që po bëhet këtu do të ishte i panevojshëm sepse nuk do të përsëriteshin të njëjtat gjëra, dhe të njëjtat mendime për projektet e njëjta, nëse ju këshilltarët nuk keni ndërruar mendime as ne drejtorët e Drejtorive nuk kemi pasur arsye të ndërrojmë ndonjë mendim ose të ndryshojmë ndonjë projekt ngase arsyet të cilat i kemi dhënë janë të tilla, të cilat nuk dua t'i përsërisë të njëjtat që i kam thënë më

gjerësisht në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në mbledhjen e Kuvendit me rastin e miratimit të vendimit për rishikimin e Buxhetit ku jo të gjithë jeni pajtuar me ato arsye dhe projekte, e që është normale për Demokracinë. Megjithatë si pasojë e mos konstituimit të Kuvendit të Kosovës është kjo pasojë edhe në ngecje të miratimeve të rishikimeve të buxheteve në Komuna, çështje të cilën askush nga ju nuk e ceku se kjo është pasoja kryesore. Komuna e Podujevës ka qenë e bllokuar që nga rishikimi i buxhetit për të gjitha projektet e parapara me rishikim, por të gjitha kontratat të cilat kanë qenë të lidhura dhe në bazë të cilave kanë qenë duke u kryer punë, punimet kanë vazhduar edhe gjatë kësaj kohe kryesisht pa mjete buxhetore ngase disponueshmëria ka qenë në pritje të asaj që është e drejtë ligjore e Komunave të bëjnë rishikimin e buxhetit, kjo nuk ka ndodh për shkak të mos konstituimit të Kuvendit të Kosovës, por është rekomanduar kjo mënyrë me ri-alokim që është po ashtu e drejtë ligjore. Sa i përket Drejtorisë me të cilën unë udhëheqë, ky ri-alokim është bërë brenda gjithë atyre kufijve të arsyeshëm që janë bërë me miratimin e vendimit për rishikim të buxhetit, dhe për të gjitha i keni marrë arsyet pse janë hequr ose pse janë paraparë projekte dhe ridestinine të mjeteve.

Ridestিনি ka disa kushtëzime të tjera shtesë ku një ndër ato është mos hapja e kodeve të reja dhe projekteve të reja, shembull, në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur muajin prill të gjithë keni kërkuar që në fshatrat Repë dhe Murgull të ndërtohen ura të reja, ndërsa me ridestinin nuk mund të ndërtohen ato ura ngase nuk lejohet të ketë kod të ri, ndërsa ne është dashur të veprojmë tërthorazi dhe t'i fusim në kodin e emëruar, riparimi i urave, për të mundësuar shpenzimin e atyre 43,000.00 €, ndërsa rasti tjetër i ngjashëm është edhe ai i cili ka të bëjë me Lagjen e Dëshmorëve në të cilën duhet të ndërtohet në dy faza kanalizimi, rrjeti energjetik dhe rrjeti i ujësjellësit, pra kanalizimin është dashur ta bartim në kodin për kanalizimet në qytet sepse nuk mund të hapen kode të reja për Lagjen e Dëshmorëve. Pra a më mirë t'i bëjmë këto ndryshime dhe të shpenzojmë buxhetin apo të hyjmë në borxhe, e që një gjë e tillë do të ishte e padrejtë, kurse ju mund të quani këtë si mos profesionalizëm apo gabim në strategji, mirëpo kjo është përpjekja e fundit që të shpenzohet sa më shumë buxhet dhe të paguhet operatorë të cilët kanë kryer punë ku vetëm në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit janë mbi 250,000.00 € punë të kryera por që nuk mund të paguhet ato punë për shkak të rishikimit të buxhetit, gjë për të cilën operatorët ekonomik nuk janë fajtorë ngase kanë nënshkruar kontratë dhe e kanë kryer punën ndërsa Komuna është e obliguar të bëjë pagesën.

U përmenden disa fshatra, por nuk i përmendi askush nga parafolësit projektet e kryera që vetëm Drejtoria e lartcekur ka iniciuar në prokurim 53 projekte ku 70% e tyre janë përfunduar në shumë fshatra.

Prandaj unë me përvojën më të madhe profesionale që kam, e kam paraqitë këtë ridestinin para juve si këshilltarë të Kuvendit për të miratuar, ridestinin i cili e shpëton në masë shumë të madhe buxhetin e Komunës dhe i stabilizon shumë shpenzimet publike apo e ulë deficitin, gjë e cila është pasojë e mos rishikimit të buxhetit nga ana e Kuvendit të Kosovës për shkaqe të njohura tash më. U përmend edhe mos planifikimi i shpenzimit të buxhetit nga ana e Drejtorisë, mirëpo të jeni të bindur se në qoftë se do bënim planifikime strikte me siguri se nuk do të mund të realizoheshin as 30% të projekteve të planifikuara. Sa i përket asaj që z. Rafet Llapashtica e tha se është duke u degraduar lumi në fshatin Dumnice si pasojë e rregullimit të kanalizimit në atë fshat, unë ju sqaroj se nuk është duke u ndërtuar kanalizim por është duke u zgjeruar lumi Dumnica dhe nuk ka asnjë ankesë nga ata qytetarë por kemi njerëz të ndryshëm, madje edhe intelektual të

cilët kanë kërkuar të drejtohet shtrati i atij lumi dhe të rregullohet sa më shpejtë, pra këto çështje mund t'i debatojmë në tjera mbledhje por jo në këtë mbledhje kur para vetës kemi ridestinimin e mjeteve, andaj edhe kërkoj nga ju që të miratoni këtë ridestitim ngase në fund të vitit do të vëreni se keni ndihmuar shumë realizimin e mirë të buxhetit dhe të projekteve të Komunës si dhe do të parandaloni borxhin e Komunës.

z. Kadri Avdiu, theksoi, drejtori parafolës i dha disa sqarime, por mendoj se nuk jemi kuptuar me atë që unë e thash më parë, unë nuk thash se nuk duhet të bëhet rishikimi i atyre mjeteve të cilat mbeten tepricë dhe barten në ato projekte ku ka mungesë të tyre, gjë e cila është shumë e qartë, mirëpo unë bëra një pyetje konkrete, dhe atë, pse nuk ka filluar puna për zgjerimin e lumit nga diga e liqenit të Batllavës ku janë të parapara 65,000.00 € të cilat njëherë barten e pastaj kthehen prapë, kurse drejtori e tha se duhet të votohet sepse do të vërehet në fund të vitit se çfarë lehtësimi i është bërë Komunës në realizimin e buxhetit, kurse unë jua rikujtoj se në vitin e kaluar kemi bërë rishikim të buxhetit dhe e kemi mbështetur të gjithë ngase ka qenë rreziku të na humbin rreth 1 milion euro, gjithashtu drejtori e tha se planifikimi strikt nuk mund të jetë real 100%, gjë me të cilën pajtohem, mirëpo nuk pajtohem me shumën afër 1 milion euro apo 1/4 e buxhetit total që ridestinohet sepse ridestnimi mund të jetë vetëm deri në 10%.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit e potencoi se me këtë ri-alokim mundësohet pagesa e operatorëve të cilët i kanë kryer punët, ndërsa me këtë propozim del se në pjesën e gjashtëmujorit të dytë është punuar në tri fshatra, me këto shuma, 200,000.00 €, 300,000.00 € dhe 90,000.00 € në fshatrat Dumnicë, Llapashticë dhe Bradash, shtroj pyetje, si e ndien vetën drejtori i kësaj Drejtorie dhe Kryetari i Komunës i cili jeton në një qytet pa semaforë të vendosur në rrugë, ku dhe jemi qyteti i vetëm në Kosovë që nuk kemi të vendosur semaforë nëpër rrugë, ndërsa vendos t'i heqë 6,000.00 € të parapara për shenjëzimin vertikal të rrugëve dhe i bartë për rregullim të kanalizimit në fshatin Bradash. Në një prej mbledhjeve të kaluara unë në këtë Kuvend e kam treguar një foto ku shihet një njeri duke mbi gypat e kanalizimit në fshatin Llapashticë të cilët nuk kanë qene fare të mbuluar me rërë, andaj unë e them se kjo qeverisje nuk është e mirë.

Çështje tjetër është se drejtori e arsyetoj këtë propozim duke thënë se duhet të bëhen pagesat ngase jemi të rrezikuar të na humbin mjetet buxhetore, por ia rikujtoj drejtorit se janë 280,000.00 € nga të hyrat vetanake të cilat nuk mund të humbin por mund të barten në vitin pasues.

Pra nuk jam në dijeni se çka i ndihmojmë Komunës me këtë ri-alokim kur kemi parasysh se në qytetin e Podujevës nuk funksionon kanalizimi, nuk funksionojnë rrugët, nuk ka trotuare, nuk ka vendparking publik, dhe mendoj se nuk mund të jetë arsye për këshilltarët e Kuvendit kur thuhet se duhet të votohet ky ri-alokim ngase na humbin 280,000.00 €, kur jemi në dijeni se ajo shumë është nga të hyrat vetanake dhe nuk mund të humbin.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, dua të bëjë vetëm një sqarim të shkurtër, vlerësimi im, se me profesionalizëm ky Ekzekutiv qëndron dobët e kam bazuar në një mbledhje të kaluar kur është paraqitur propozimi i vendimit për rishikimin e buxhetit i cili ishte në një vlerë prej afro 1,200,000.00 €, vendim i cili tani duhet të zëvendësohet me këtë ri-alokim, e që i bie se Ekzekutivi i Komunës brenda një viti rreth 18% - 20% nuk i përmbush planifikimet me shpenzime buxhetore.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë në fillim të mbledhjes nuk e pash arsyeshme që drejtorët e Drejtorive të arsyetojnë këtë propozim ngase konsideroj se të gjitha arsyet janë dhënë në mbledhjen kur është debatuar për rishikimin e buxhetit, por megjithatë dua t'i jap disa përgjigje. U përmenden disa projekte dy vjeçare, përkatësisht për fshatrat Balloc, Dumnicë dhe Llapashticë, në të cilat vitin e kaluar kanë filluar punimet por për shkak se nuk kanë mjaftuar mjetet buxhetore është paraqitur nevoja që të vazhdohet edhe në këtë vit me punime dhe për të gjitha këto punime ekziston dokumentacioni përkatës ku punët janë kryer në bazë të legjislacionit.

Disa nga diskutuesit e thanë se investimet janë duke u bërë në baza partiake gjë e cila për mendimin tim nuk qëndron ngase investimet që janë bërë, ato që janë duke u bërë dhe ato që janë të planifikuara i përfshijnë të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës.

Çështje tjetër që dua të përmend është edhe shpenzimi i buxhetit në mandatin e kaluar, sigurisht se disa nga ju keni qenë këshilltarë edhe në mandatin e kaluar dhe jeni në dijeni se Komuna e Podujevës buxhetin e ka shpenzuar mbi 99% gjë e të cilën rrallë herë e bëjnë ndonjë Ministri apo ndonjë Komunë në Kosovë, pra kjo do të thotë se efikasiteti i Komunës ka qenë i lartë. Gjithashtu vlen të përmendet puna e Prokurimit, punë nga e cila gjatë këtyre tri – katër viteve të fundit nuk ka pasur asnjë ankesë për procedurat e zhvilluara të prokurimit.

Konsideroj se nuk paraqitet nevoja të thellohem më shumë në këtë propozim meqë këto ridestinime janë miratuar një herë me rastin e miratimit të vendimit për rishikimin e buxhetit dhe tani për shkaqe të njohura tani më, na paraqitet prapë ky propozim me disa ndryshime të vogla, andaj këtë propozim vendim dhe sipas rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se me 19 vota për, 16 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua propozim vendimi për ri-alokim dhe transfer të projekteve për vitin 2014.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00'

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-88620
Podujevë,
17 tetor 2014**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**